



This project is funded
by the European Union



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



PARTITË POLITIKE DUHET TË PRAKTIKOJNË ATË QË PREDIKOJNË, KY ËSHTË ÇELËSI

Nga Adrian ZALLA

Demokracia si sistem, ide e koncept është shumë e shtrenjtë për tua lënë në dorë vetëm partive politike, politikanëve apo analistëve politikë. Demokracia është si trupi dhe mendja e njeriut, për t'i mbajtur të shëndosha duhet të punosh çdo ditë me to, për to, për ti ruajtur shëndetin, formën, përmbajtjen, stabilitetin, por edhe bukurinë natyrale biologjike. Por, a e bëjnë partitë politike këtë? Ose, a mundohen të paktën?

Demokracia në Shqipëri është vërtetë e re, ama fakti që është e re nuk duhet përdorur më si justifikimet e fëmijëve në shkollë përpara mësuesit për t'iu shmangur përgjegjësisë dhe qortimit. Sepse as ata nuk mjaftojnë përherë, siç mirë e dimë të gjithë. Partitë politike në vendin tim ofrojnë vetëm mjerim, autokraci, militantizëm, dhe shpërblim në bazë të besnikërisë, mbrojtjes së liderit, uniformitetit të mendimit konform partisë, pjesëmarrjes në mitingje, tubime e protesta të organizuara nga partia, fakt jo opinion personal.

Demokracia e brendshme në parti është si "demokracia e brendshme në shtëpi"! Në një shtëpi ku bëhet vetëm monolog, përveçse asnjë nuk është i lumtur, madje as protagonist i monologut. Në një shtëpi të tillë ka gjithmonë të ngjarë të ndodhin tmerre, si mbyllje goje, mohim të drejtash, dhunë psikologjike ose fizike, martesë me mblesëri, mohim lirie për të vepruar sipas dëshirave, etj. Zbatimi rregullave në shtëpi të tilla është detyrim ose ndryshe të përzënë nga shtëpia, të vrasin, ose të shpallin "të vdekur për ta" një lloj "non grata" familjare. A shohim ose gjejmë ndonjë të mirë në një shtëpi të tillë...?

Le të ndalimi tek partitë shqiptare. Partia Demokratike, pas ardhjes së Bashës në fronin e kryetarit në 2013 shpalli "non grata" këdo që i shpalli luftë apo foli kundër tij, figura të rëndësishme të partisë demokratike ndër dekada si ish-kryeparlamentarja znj.Topalli, përveç kësaj në njëfarë mënyre duke i lënë jashtë

Fituese në konkursin me ese "Mbi pikëpamjet e të rinjve mbi partitë politike dhe rolin e tyre në promovimin e demokracisë në Shqipëri. Realizuar në kuadër të projektit "Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen", i cili po jetësohet nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe Civil Rights Defenders (CRD), me mbështetjen e Bashkimit Europian.

listash për deputetë në 2017 i dha fund karrierës së shumë ikonave të kësaj partie. Me të njëjtën formë veprimi edhe me ata që mohuan djegien e mandateve, por njëllon edhe me të tjerët që e mirëpritën pranimin e tyre, me përjashtim, me shpallje "non grata" kështu në njëfarë forme duke i dhënë fund edhe karrierës së tyre politike në 2019: Rasti i Rudina Hajdarit që e futën në lista si simbol të rikthimit të demokracisë, shpresës e ndryshimit si e bija e Azem Hajdarit e cila u kthye në shami turpi, sulmi, dhe hedhje e pritjeje nga pati mundësi, sesi përfundoi historia e saj, e dini të gjithë. A ju duket ky një proces i drejtë? Një proces meritokratik? Një proces i barabartë, i drejtë dhe demokratik? Përgjigje brenda pyetjeve nuk ka, por ndër vite si edhe në zgjedhjet e fundit për kryetar Basha dhe PD janë përgjigjur qartë për gjithçka...

Kalojmë te Partia Socialiste e cila nuk ka zgjedhje të brendshme për kryetar të saj të paktën prej 12 vitesh, që në 2009 kur përballë z. Rama ishte Maqo Lakrori, nuk është shaka, është fakt, a kemi të bëjmë me zbatim të demokracisë së brendshme të partisë në këtë rast? A sjell kjo gjë një lloj autokracie qoftë edhe padashje në PS? Dalim te sistemi meritokratik i kësaj partie, e nisim me fatin e Ben Blushit dhe lëvizjeve të tij deri te shpallja "non grata" e tij nga z. Rama ku më pas ai do botonte një letër-libërth drejtuar socialistëve, dhe themelimin e partisë "LIBRA", e cila ishte një nismë që dështoi me sukses të plotë. Kundërshtari më serioz dhe i vetmi që kishte një mundësi reale për ti marrë fronin e PS-së Ramës, falë këtij të fundit karriera politike e Blushit mori fundi. Rama me lëvizjet e tij nxorri jashtë loje njëllon si z.Basha por në një mënyrë më elegante e të sofistikuar figura të rëndësishme të asaj partie si Arta Daden, Ditmir Bushatin e së fundmi në zgjedhjet e 2021 ai me listat që hartoi, nxorri jashtë politikës ikona të Partisë Socialiste si Pandeli Majkon e Mimi Kodhelin. A kemi të bëjmë edhe këtu me një sistem meritokratik, të drejtë, të barabartë e demokratik?

Bëmë një lloj historiku të partive më të mëdha në vend në mbështetje të argumentit që demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare është inekzistente ose e shtirur, një lloj sapuni që tentohet të na shitet për djathë por që dështon gjithmonë ose mbetet mall stok. Meritokracia brenda partisë pastaj është një gazmore e madhe po të marrim rastin e ministres Besa Shahini ose ministrit, zv/ministrit të Jashtme z. Gent Cakaj, ende nuk dimë, si u përzgjedhën? Pse u përzgjedhën? Çfarë meritash kishin në PS apo në shoqërinë shqiptare të Shqipërisë para se të merrnin poste ministrorë? Se më pas të gjithë e dimë, rrogë morën por kontribut nuk dhanë, veçse sollën rrëmujë në media por edhe në shoqëri, duke pasur parasysh se arsimiti është shtylla e një shoqërie.

Rasti më i fundit, B.Muzhaqi, me tre muaj në politikë me një shqipe modeste, me një shkollim relativisht të mirë sipas asaj që ka vetëdeklaruar, dhe me një adhurim të

pakundërshtueshëm e padiskutueshëm ndaj Ramës u emërua zv/ministre arsimit. A mjafton kaq për ta bërë zv/ministre arsimit? Raste si këto ka pafund...

Mungesa e demokracisë së brendshme e mbyt individualitetin, spikatjen e më të mirëve, krijon nepotizëm, grupime jo të shëndetshme, luftë të brendshme, armiqtë që shkatërrojnë frymën e bashkëpunimit, përçarje, etj, gjëra që çojnë në një funksionim të çalë të partisë, por edhe mesazheve që ajo jep.

Është si të thuash një narkotrafikant drejton një organizatë kundër krimit dhe korrupsionit, kur një parti pa demokraci të brendshme kërkon demokraci në vend! Demokracia është një lidhje seri, por fillon nga liderët, nga partitë, nga demokracia e brendshme në të, demokracia brenda partive forcon edhe demokracinë në vend, pasi ndjell inspirim, ofron besim e shpresë për ndryshim por edhe për pjesëmarrje aktive.

Susan Scarrow thotë që: *"Partitë politike duhet të praktikojnë atë që predikojnë!"* Shembulli: Thonë para ligjit jemi të gjithë njësoj? A është e vërtetë? Autorët e skandaleve më të mëdha në këtë vend jo vetëm që kanë dalë pa u lagur por nuk i janë nështruar as një hetimi të hollësishëm mbi ngjarjet e krimet e supozuara por janë pushuar nga gjykata madje edhe duke shpërblyer "fajtorin/ët e presupozuar": Rasti i vjedhjes së Bankës së Shqipërisë në kohën e ish-guvernatorit të saj z.Fullani e dëshmon qartë këtë!

Pra A-ja e një shteti është demokracia funksionale, A-ja për ta ndërtuar këtë është demokracia e brendshme brenda partive politike, hartimit të rregulloreve dhe statutit të partisë, por edhe vetë njeriut, pasi si thotë Aristoteli: *"Njeriu është kafshë politike"* pra njeriu është një konstrukt qelizash, organesh, kockash gjaku e uji njëlloj si kafsha, por politika e bën të ketë një ide, një mendim, një qëndrim dhe një vendim të gjitha këto e bëjnë njeriun *"një kafshë politike"* të aftë të emancipohet e të ndërtojë gjëra të mëdha!

Një shtet me demokraci të mirë e funksionale (Pasi demokracia e përsosur nuk ekziston, këtë e marrim si aksiomë, e besojmë dhe e mbyllim aty), ndërton një komb me ndërgjegje, me ndërgjegje sociale mbi të gjitha, dhe një komb me ndërgjegje sociale është i gatshëm të marrë përgjegjësinë e veprimeve të veta, por edhe të ndihmojë në procesin e ruajtjes, zhvillimit e lulëzimit të demokracisë.

Partitë politike duhet të praktikojnë atë që predikojnë, ky është çelësi...